

Drejtoria Rajonale Burrel

Nr.Prot. _____

Burrel, më _____._____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT **(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “**RAFIN COMPANY**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L52125110A**, me seli: *Tiranë, Tiranë, Rruga “Haxhi Kika”, Tiranë, Njësia administrative nr.5, nr.pasurie 6/538, hyrja 1, apartamenti 4.*

Procedura e prokurimit: “**E Hapur - Punë**”, prokurim elektronik.

Numri i referencës së procedurës: **REF-93326-01-17-2024**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Rikonstrukcion i rrjetit ‘TU’ 0.4kV me kabëll ‘A.B.C’ në njësinë Bulqizë, Drejtoria Rajonale Burrel, Zonat Gjoricë, Fushë Bulqizë, Zerqan, Krast, Trebisht**”, me fond limit në vlerën: **279,022,659** (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH**, me afat realizimi: **310 (treqind e dhjetë) ditë kalendarike nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.**

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 3, datë 22 Janar 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “**MUHOPLUS LTD**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L52317046G**,
Vlera: **275 853 665.90** (dyqind e shtatëdhjetë e pesë milion e tetëqind pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë nëntëdhjetë) **lekë pa TVSH.**
2. Operatori Ekonomik: “**NDERTIMI**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K11325002C**,
Vlera: **272 099 937.21** (dyqind e shtatëdhjetë e dy milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë pikë njëzet e një) **lekë pa TVSH.**
3. Operatori Ekonomik: “**RAFIN COMPANY**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L52125110A**,

Drejtoria Rajonale Burrel

Vlera: **269 434 149.64** (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë e njëqind e dyzet e nëntë pikë gjashtëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “**MUHOPLUS**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L52317046G**,
2. Operatori Ekonomik: “**NDERTIMI**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K11325002C**,

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “**MUHOPLUS**” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

- I. Nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara në **pikat 2.2.1** dhe **2.2.2/ 2.2** Kapaciteti ekonomik dhe financiar / 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk janë paraqitur vërtetimi për xhiron vjetore dhe bilancet vjetore për vitet financiare 2020, 2021, dhe 2022.
- II. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.1/ 2.3** Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se, nuk përmbush vlerën e kërkuar për punët e ngjashme, si për një objekt të vetëm (139,511,329.5 lekë), ashtu dhe për disa objekte (558,045,318 lekë), si dhe nuk është paraqitur i gjithë dokumentacioni për kontratat e mëparshme të paraqitura, si më poshtë:
 - Për kontratën me objekt: “*Rikonstruksion rrjeti TU me kabëll ABC Rajoni Korçë*” nuk është paraqitur dokumentacioni: Kontrata e bashkëpunimit ndërmjet bashkimit të Op. Ek. pjesëmarrës, dhe Akti i Kolaudimit të objektit;
 - Për kontratën me objekt: “*Rehabilitim objekteve dhe mbrojtje lumore, i ndarë me lote, Loti 1 – “Rehabilitim/ Rikonstruksion hidrovoresh/ Rehabilitimi i Hidrovorit të Cukës*” nuk është paraqitur dokumentacioni: Situacioni Përfundimtar i punimeve, Akti i Kolaudimit të objektit, dhe Çertifikata e marrjes në dorëzim të objektit;
 - Për kontratën me objekt: “*Rikonstruksion i Seksionit 6KV*” nuk është paraqitur dokumentacioni: Situacioni Përfundimtar i punimeve dhe Çertifikata e marrjes në dorëzim të objektit;
 - Për kontratën me objekt: “*Rikonstruksion kabine elektrike dhe ndërtimi rrjeti TU me përcjellës al me vetëmbajtje të tipit ABC për fiderin 1, 2, 4 N/St 35/10 Rrogzhinë dhe kalimi i ngarkesës së kabinave elektrike nga fideri 4 në fiderin 2 N/St Rrogzhinë*” nuk është paraqitur dokumentacioni: Akti i Kolaudimit të objektit (pasi investimi është me ent publik), Çertifikata e marrjes në dorëzim të objektit, si dhe nuk është paraqitur miratimi i Autoritetit Kontraktor për

Drejtoria Rajonale Burrel

Kontratën e Nënkontraktimit me shoqërinë “MUHOPLUS LTD” Sh.p.k., si dhe kontrata e nënkontraktimit nuk është bërë sipas formës së kërkuar nga ligji (e noterizuar), parashikuar këto në nenin 126 të LPP-së dhe nenin 89 të VKM-së nr. 285, dt.19.05.2021, (të njëjtin përcaktim ka dhe ligji ekzistues i prokurimit publik).

- III. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.2/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk disponon kategoritë e liçencës të kërkuar: Kategorinë NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit), Kategorinë NS-8 (Ndërtime parafabrikat me beton arme, struktura metalike dhe druri), dhe Kategorinë NS-18 (Punime topogjeodezike).
- IV. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.3/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur Çertifikata ISO 27001:2013 dhe ISO 39001:2012.
- V. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.4/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur licenca (Kodi III.2.B) “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”
- VI. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.5/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për disponimin/ kontraktimin e/me një laborator testimi të materialeve.
- VII. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.6/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se,
- Për materialet: Shtylla druri, Kabëll Koaksial Cu 1 x 6/6 mm, Kabëll Koaksial Cu 4 x 10 mm, dhe Tokëzim shtylle TU nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar, si: *Autorizimet e prodhuesit/ distributorit, Katalogjet dhe Dëshmitë e testimëve zyrtare të kryera.*
 - Për materialet: Shtylla b/a të centrifiguara, Transformator fuqie 6-10 kV, Izolator Porcelani 10 Kv, Ndarës Linje të Jashtëm, Kabllot e Tensionit të Ulët (A.B.C), Aksesoret e linjave ABC, Panel “TU” 0.4 KV, Matës Elektronik për matjen e energjisë, dhe Kabëll PVC TU 06/1 kV nuk janë paraqitur *Autorizimet e prodhuesit/ distributorit*, si dhe *Raportet e Testimeve zyrtare të paraqitura janë në gjuhë të huaj, të papërkthyer.*
 - Për materialet: Traversa model “Y” për linja 10 kV, Siguresa TM, dhe Transformatorët e rrymës TU nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar, si: *Autorizimet e prodhuesit/ distributorit dhe Dëshmitë e testimëve zyrtare të kryera.*
- VIII. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.7/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8* të paraqitur, ka deklaruar se disponon vetëm 13 (*trembëdhjetë*) punonjës nga 110 (*njëqind e dhjetë*) punonjës të kërkuar.

Drejtoria Rajonale Burrel

- IX. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.8 gërma “a”**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8* të paraqitur, nuk ka deklaruar disponimin e inxhinierëve: *Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Mjedisi, Inxhinier Gjeolog, dhe Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder.*
- X. Nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara në **pikat 2.3.8 gërma “b/c/d/e/f”, 2.3.9 dhe 2.3.10/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8* të paraqitur, nuk ka deklaruar disponimin e punonjësve të kualifikuar/ çertifikuar të kërkuara në këto pika, manovratorëve dhe automjeteve/ makinerive/ pajisjeve.
- XI. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.11/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për disponimin/ kontraktimin e 1 (një) kantier për prodhimin e betonit në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi.
- XII. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.12/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës nuk janë paraqitur mostrat për materialet/ pajisjet e kërkuara, pranë autoritetit kontraktor ditën e hapjes së ofertave.
- XIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.13/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës nuk është paraqitur grafiku i punimeve.
- ❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “NDERTIMI” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:**
- I. Nuk është paraqitur preventivi i punimeve.
- II. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.2.1/** 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në vërtetimin e paraqitur për xhiron vjetore, konstatohet se nuk përmbush vlerën e xhiros së kërkuar për të paktën **1 (një)** nga vitet e periudhës së kërkuar.
- III. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.1/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur kontrata për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.
- IV. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.2/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në liçencën e shoqërisë konstatohet se, nuk disponon klasifikimin C të

Drejtoria Rajonale Burrel

kërkuar për kategorinë NP-11 (*Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e mesëm dhe shpërndarjen e energjisë*).

- V. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.3/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur Çertifikata ISO 27001:2013.
- VI. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.5/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për disponimin/ kontraktimin e/me një laborator testimi të materialeve.
- VII. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.6/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar, si: *Autorizimet e prodhuesit/ distributorit, Katalogjet dhe Dëshmitë e testeve zyrtare të kryera, për listën e mallrave/ materialeve të kërkuar.*
- VIII. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.7/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8* të paraqitur, ka deklaruar se disponon vetëm 54 (*pesëdhjetë e katër*) punonjës nga 110 (*njëqind e dhjetë*) punonjës të kërkuar.
- IX. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.8 gërma “a”/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8* të paraqitur, nuk ka deklaruar disponimin e inxhinierit gjeolog.
- X. Nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara në **pikat 2.3.8 gërma “a/b/c/d/e”/** 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8* të paraqitur, konstatohet se:
- Nuk disponon inxhinierin gjeolog;
 - Nuk disponon punonjësin Elektroteknik;
 - Nuk disponon punonjësin Elektromekanik;
 - Nuk disponon numrin e kërkuar prej 25 (*njëzet e pesë*) punonjës elektrikist, por vetëm 3 (*tre*) prej tyre, si dhe për këto të fundit nuk është përcaktuar kategoria e Sigurimit Teknik.
 - Nuk disponon numrin e kërkuar prej 4 (*katër*) punonjës murator, por vetëm 1 (*një*) prej tyre.
 - Nuk disponon numrin e kërkuar prej 4 (*katër*) punonjës karpentier, por vetëm 2 (*dy*) prej tyre.
 - Nuk disponon 1 (*një*) punonjës i specializuar/ trajnuar si *vincier*, dhe 1 (*një*) punonjës specialist si *Ekspert zjarrëfikës*.
 - Nuk disponon numrin e kërkuar prej 10 (*dhjetë*) punonjës të specializuar dhe çertifikuar për punime në lartësi, por vetëm 1 (*një*) prej tyre.

Drejtoria Rajonale Burrel

- XI. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.10** gërma “a/b”/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi bazuar në *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8* të paraqitur, konstatohet se:
- Nuk disponon automjetet/ makineritë dhe pajisjet: Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton; Kamion me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton; Mjet për riparim linja me kosh (*me krah deri 25 m*); Autovinç me kosh; Ekskavator me goma; Fadromë; Minieskavator; Mini-fadrome; Autobetoniere me kapacitet deri në 3.5 m³ për punime në kantier; Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kabllave; Kit vegla pune; Set karrukulla për shtrirjen dhe tërheqjen e përcjellësit për pozicione horizontale; Pajisje tërheqëse për përcjellësa (deri 30 KN me lexim elektronik); Kenotron për kablllo; Megamotor 500 volt; Megamotor 2500 - 5000 volt, dhe Pajisje tërheqëse për kablllo (me dinamometër).
 - Nuk disponon numrin e kërkuar prej 3 (*tre*) Eskavator me zinxhirë, por vetëm 1 (*një*) prej tyre.
 - Për pajisjet: Vibrator betoni dhe Gjenerator për kantierin, nuk ka deklaruar datat e faturave tatimore të shitjes.
 - Për mjetet dhe pajisjet mbrojtëse në punë nuk ka deklaruar numrat dhe datat e faturave tatimore të shitjes.
- XII. Nuk është përmbushur kriteri i **pikës 2.3.11**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi konstatohet se, nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar për disponimin/ kontraktimin e 1 (*një*) kantier për prodhimin e betonit në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi.
- XIII. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.12**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës nuk janë paraqitur mostrat për materialet/ pajisjet e kërkuara, pranë autoritetit kontraktor ditën e hapjes së ofertave.
- XIV. Nuk është përmbushur përcaktimi i **pikës 2.3.13**/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës nuk është paraqitur grafiku i punimeve.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: “**RAFIN COMPANY**” Sh.p.k., me seli: *Tiranë, Tiranë, Rruga “Haxhi Kika”, Tiranë, Njësia administrative nr.5, nr.pasurie 6/538, hyrja 1, apartamenti 4*, me numër Nipt-i: **L52125110A**, se oferta e paraqitur, me vlerë të përgjithshme prej: **269,434,149.64** (*dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë e njëqind e dyzet e nëntë pikë gjashtëdhjetë e katër*) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Drejtoria Rajonale Burrel

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Drejtorisë Rajonale e OSSH, Burrel/ Dega e Shërbimeve Mbështetëse, me adresë: *Rruga "Ibrahim Temo", lagja "Partizani", Burrel*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10 (dhjetë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

Titullari i Autoritetit Kontraktor